



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z. BELINDA BALLUKU

NISMA PËR RISHIKIMIN E

**PLANIT TË DETAJUAR TË ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK)
MES LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE LUMIT SEMAN, MIRATUAR ME
VENDIM TË KKT-SË NR. 3, DATË 26.07.2018**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, Datë 28.07.2020

Hartuar nga

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



Përmbajtja

1. Nevoja dhe Qëllimi për rishikimin e PDZRK-së	3
2. Dokumentet dhe pjesët përbërëse, subjekt rishikimi.....	4
3. Ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit	4
4. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike	4
5. Plani i veprimeve për rishikimin e dokumentit	5
6. Kufiri i PDZRK-së, për rishikim	6
7. Çështje të fundit.....	7
<i>Shtojca 1: Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Këshillit të Ministrave nr. 6/9, datë 24.06.2020</i>	<i>7</i>
<i>Shtojca 2: Harta e kufirit të zonës për rishikim</i>	<i>7</i>
<i>Shtojca 1</i>	<i>8</i>
<i>Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Këshillit të Ministrave</i>	<i>8</i>
<i>Shtojca 2</i>	<i>11</i>
<i>Kufiri i Zonës për Rishikim: Njësia Strukturore DJ_B_B_4</i>	<i>11</i>



1. Nevoja dhe Qëllimi për rishikimin e PDZRK-së

Nevoja për rishikimin e Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) për miratimin e një investimi që prek kufirin e PDZRK-së, **Vendimi KIS nr. 6/9 datë 24.06.2020**, Shtojca nr. 2.

Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendim Nr. 4 datë 20.06.2018 ka miratuar nismën për hartimin e “Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman”, me kërkesë të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS).

Më tej, KKT me vendim Nr. 3 datë 26.07.2018 ka miratuar “Planin e Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman” me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT).

Rishikimi i PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman përbën një detyrim ligjor në bazë të përcaktimeve të Ligjit 107/2014 për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, i ndryshuar, Neni 26 i të cilit përcakton se:

1. *Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.*
2. *Rregullat dhe procedura e ndryshimit të planeve apo rishqyrtimit të plotë të tyre, sipas këtij neni, do të përcaktohen në rregulloren e planifikimit.*

Sipas VKM-së Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, Neni 11 përcaktohet se:

3. *Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave.*
4. *Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:*
 - a) *Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;*
 - b) *Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;*
 - c) *sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.*

Lidhja e PDZRK-së me investimet strategjike jepet në VKM-në Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Neni 33, Pika 2:

“ Objekti i Planit të Detajuar për një Zonë të Rëndësisë Kombëtare janë ndër të tjera dhe:

b) Investime të rëndësishme dhe strategjike që nxisin zhvillimin e territorit dhe kanë ndikim kombëtar.”

Ne vijim të miratimit të propozimeve për investime strategjike, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, si institucion qendror në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe sekretariatit i KIS, me shkresën Nr. 187/9 prot datë 09.07.2020, i drejtohet AKPT-së duke i kërkuar ndër marrjen e nismës për rishikimin e PDZRK-së, për një nënjësi të zonës Karavasta-Seman, si dhe kryerjen e procesit të bashkërendimit për hartimin e tij.



Qëllimi i rishikimit të PDZRK-së është përshtatja e zhvillimeve dhe infrastrukturave të lejuara nga plani në funksion të nga investimet strategjike miratuar nga KIS, duke siguruar bashkërendimin dhe respektimin e legjislacionit sektorial dhe dokumenteve të planifikimit në fuqi për territorin subjekt zhvillimi.

2. Dokumentet dhe pjesët përbërëse, subjekt rishikimi

Në përputhje me përcaktimet e neneve 37-38 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", hartimi i PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i është përmbajtur Fazës III të hartimit, duke qënë se ky territor ishte studiuar paraprakisht nga PPV Divjakë dhe Fier, dhe zhvillimi i tij ishte orientuar nga vendimet e KIS.

Dokumentet e miratuara dhe në fuqi të PDZRK-së përfshijnë:

- a) Planin e Detajuar të Zhvillimit;
- b) Rregulloren e Detajuar të Planit;
- c) Hartat shoqëruese.

Përditësimi i propozimeve të PDZRK-së, sipas përcaktimeve të Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 6/9, datë 24.06.2020, "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 6/4, datë 19/4/2018 të KIS "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe finger lime në zonën e Karavastasë bashkia Divjakë", me subjekt aplikues "Agro Iliria group" sh.p.k. NUIS/NIPT L51320033L", **kërkon ndryshime në kategoritë/nënkategoritë e lejuara të përdorimit të tokës për lejimin e agroturizmit në një zonë me një sipërfaqe prej 131 ha.**

3. Ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit

Rishikimi i Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman hartohet në bashkërendim me ministrinë dhe institucionet e linjës për fushat/çështjet të cilat ai trajton:

- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT);
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA, MFE);
- Bashkia Divjakë.

Fushat e ekspertizës për hartimin e PDZRK-së përfshijnë:

- planifikimin e territorit;
- mjedisin;
- bujqësinë;
- turizmin.

Bazuar në kompetencën në fushat përkatëse, përgjegjës për rishikimin e PDZRK-së do të jenë përfaqësues nga institucionet e listuara më sipër.

4. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike

Në zbatim të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 12 përcaktohet se:



3. Bashkërendimi, këshillimi dhe takimet publike, sipas përcaktimeve të dokumentit të nismës, të vendosura në bashkëpunim me Agjencinë

Për informimin e aktorëve të përfshirë organizohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të paktën një takim i Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit në nivel Qëndror (FBPQ). Në përfundim të takimit, grupi i punës përgatit raportin final me vërejtjet dhe/apo propozimet e shprehura të reflektuara dhe të bashkëlidhura dokumentit.

5. Plani i veprimeve për rishikimin e dokumentit

Plani i Veprimit për Rishikimin e Planit, përcakton procesin nëpërmjet procedurës së thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit. Pas hartimit të dokumentit të Nismës do të vijohet me hapat si më poshtë:

1. Hartimi i dokumentit të rishikuar të planifikimit
 - Dokumenti i rishikuar i PDZRK-së, i cili do të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit do të përmbajë vetëm propozimet e ndryshimeve të përcaktuara qartë.
 - Dokumenti i rishikuar i PDZRK-së përmban:
 - a. Relacionin shpjegues, ku detajohen qartë të gjitha ndryshimet që propozohen me referenca të specifikuara, si dhe argumentimin e ndryshimeve të propozuara;
 - b. Dokumentin me ndryshime të Rregullores së Planit, Planit të Zhvillimit, Pasaportave, i formuluar me referenca të specifikuara (si është/si ndryshon);
 - c. Pjesët (shapefile) të databazës së informacionit gjeohapësinor (GIS), të PDZRK-së, që preken nga ndryshimet, me këto të fundit të reflektuara.

2. Bashkërendimi, këshillimi dhe takimet publike
Bashkërendimi, këshillimi dhe takimet publike, sipas përcaktimeve të dokumentit të nismës, të vendosura në bashkëpunim me Agjencinë.

3. Miratimi i dokumentit të rishikuar të planifikimit
Miratimi kryhet sipas përcaktimeve në seksionet përkatëse në këtë rregullore, ku tregohet procesi i miratimit:
Dokumenti i rishikuar i PDZRK-së miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.
 - Pas botimit në Regjistër të materialeve të plota të PDZRK-së së rishikuar, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit bën kërkesën për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit të PDZRK-së në KKT.
 - KKT merr vendim në lidhje me miratimin e dokumentit të rishikuar të PDZRK-së.

Materialet që dorëzohen/botohen për miratimin në KKT të dokumentit të rishikuar të PDZRK-së janë:

- Nisma për rishikimin e PDZRK-së nga autoriteti përgjegjës;
- Dokumentet e PDZRK-së së rishikuar;
- Akti i Përputhshmërisë nga Agjencia ose deklarata e përputhshmërisë në heshtje.

4. Hyrja në fuqi e dokumentit të PDZRK-së së rishikuar
Vendimi i miratimit të dokumentit të PDZRK së rishikuar botohet në RKPT. Dokumenti i Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare (PDZRK) së rishikuar hyn në fuqi me botimin e plotë në RKPT të vendimit të KKT-së dhe dokumenteve shoqëruese të tij.

*Periudha e parashikuar për hartimin dhe miratimin e dokumentit të rishikimit të PDZRK-së do të jetë 2 muaj dhe do të shtrihet në intervalin **Gusht – Shtator 2020**.*



6. Kufiri i PDZRK-së, për rishikim

Kufiri i PDZRK-së që do të përfshihet në procedurën e rishikimit, mes Lagunës së Karavastës dhe Lumit Seman i përgjigjet vendimit dhe propozimit të KIS për investimet strategjike si më poshtë:

- **Vendim i KIS Nr. 6/9, datë 24.06.2020,** "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 6/4, datë 19/4/2018 të KIS "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngrija e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe finger lime në zonën e Karavastës bashkia Divjake", me subjekt aplikues "Agro Iliria group" sh.p.k. NUIS/NIPT L51320033L.

Vendimi i KIS pozicionohet në njërin prej Nënjesive Strukturore të PDZRK-së. Si rrjedhojë, rishikimi i Planit do të fokusohet në Nënjesinë Strukturore DJ-B_4, sipas Figurës 1 më poshtë.




Figura 1 PDZRK Laguna Karavastë – Lumi Seman, Harta e Nënjesive Strukturore



Referuar vendimit dhe propozimit të sipërpërmendur të KIS-it dhe Këshillit të Ministrave, orientimet paraprake për rishikimin e përdorimit të tokës për PDZRK-në, jepen si më poshtë.

Përdorimi Ekonomi Bujqesore [EB] - Vendim i KIS Nr. 6/9, datë 24.06.2020, ku jepet orientimi për zhvillimin e Agroturizmit;

Ky përdorim i propozuar do të reflektohet në hartën e përdorimit të tokës së PDZRK-së, si edhe në pasaportën e zhvillimit të Nënjesisë Strukture DJ_B_B_4, pjesë e Rregullores së Planit, Figura 2 dhe 3, në Shtojcën 2.

7. Çështje të fundit

Pjesë integrale e Nismës janë edhe 2 Shtojcat:

Shtojca 1: *Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Këshillit të Ministrave nr. 6/9, datë 24.06.2020*

Shtojca 2: *Harta e kufirit të zonës për rishikim*



Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Këshillit të Ministrave

Vendim i KIS Nr. 6/9, datë 24.06.2020, "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 6/4, datë 19/4/2018 të KIS "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe finger lime në zonën e Karavastasë bashkia Divjakë", me subjekt aplikues "Agro Iliria group" sh.p.k. NUIS/NIPT L51320033L.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 6/9, DATË 24.06/2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 6/4 DATË 19/4/2018 TË KIS "PËR MIRATIMIN E STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK "NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, GOJI BERRY, AVOKADO DHE FINGER LIME NË ZONËN E KARAVASTASË BASHKIA DIVJAKË", ME SUBJEKT APLIKUES "AGRO ILIRIA GROUP" SH.P.K. NUIS/NIPT L51320033L"

Në mbështetje të Nenit 8, 9, 10, 17, 18, 21, Kreut VII të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë" dhe Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë:

VLERËSOI

- Komiteti i Investimeve Strategjike, me Vendimin Nr. 6/4 datë 19/4/2018 "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe finger lime në zonën e Karavastasë Bashkia Divjakë", me subjekt aplikues "Agro Iliria Group" shpk NUIS/NIPT L51320033L, ka vendosur miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik, në një sipërfaqe toke prej 800 ha, pasi të bëheshin verifikimet kadastrale të zones;
- Pas verifikimeve kadastrale të zones, për këtë projekt u miratuan dy Vendime të Këshillit të Ministrave, përkatësisht VKM Nr. 355, datë 20.04.2018 dhe VKM Nr. 619 datë 18.09.2019, të cilët miratuan kalimin në Fondin e Pasurive Të Paluajtshme Për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPFMS) të sipërfaqes totale prej 496.6 ha dhe vënien në dispozicion të projektit;



- Duke qenë se subjekti aplikues ka përgatitur një plan më të detajuar të mbjelljes së kulturave duke kryer teste specifike, në zonën e vënë në dispozicion, për të evidentuar faktorët biologjikë, të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në prodhimin bujqësor dhe se rezultatet e testeve kanë treguar se për kulturat e *finger lime* dhe *avokado* toka e kripur është jokualitative dhe joproduktive, subjekti propozues argumenton se është e nevojshme zëvendësimi i kulturave me kivi, rrush, dardhë etj;
- Subjekti ka paraqitur kërkesë edhe për ndryshimin e vendimit Nr. 6/4 datë 19/4/2018 të KIS, pasi plani i biznesit të shoqërisë ka pësuar një ndryshim pjesor duke parashikuar dhe zhvillimin e agro-turizmit në këtë zonë;
- Duke qenë se lloji i projektit të synuar nuk ka ndryshuar dhe vlera e investimit me numrin e punësimit plotësojnë kriteret e parashikuar nga legjislacioni;

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Ndryshimin e Vendimit Nr. 6/4, datë 19/4/2018 "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe *finger lime* në zonën e Karavastasë Bashkia Divjakë", me subjekt aplikues "Agro Iliria Group" shpk Nuis/Nipt L51320033L, si më poshtë vijon:

1. *Miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë".*
2. *Subjekti propozues duhet të nënshkruajë Marrëveshje të Garancive Financiare (MGF) me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.*
3. *Statusi strategjik "Investim/Investitor Strategjik me Procedurë të Asistuar" i jepet projektit të investimit "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë", për një periudhë 3 (tre) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të truallit prej 496.6 ha, në ZK. Nr.2085, i cili përcaktohet nëmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave.*
4. *Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:*
 - a. *Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuar, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;*
 - b. *Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit;*
 - c. *Miratimin në parim dhe lejimin e përdorimit të truallit me sipërfaqe 496.6 ha, me tarifën simbolike 1 Euro, për realizimin e fermës "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj.,*



dhe zhvillimin e agroturizimit, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”.

5. Ky vendim miraton dhe planin e veprimit për çdo masë mbështetëse të kërkuar nga subjekti dhe miratuar me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike.
6. Në zbatim të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408 datë 15.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të bëhet rishikimi i PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman, të miratuar me vendimin e KKT nr. 3 datë 26.07.2018, përpara aplikimit për lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit.
7. Ministri i Ekonomisë dhe Financës ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e pasojave, ndryshim të VKM Nr. 355 datë 20.04.2018 dhe VKM Nr. 619 datë 18.09.2019, sipas parashikimeve të këtij vendimi.
8. Subjekti nuk duhet të ndryshojë më projekt investimin dhe në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik "Ngritja e plantacionit me shëgë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë" konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
9. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike.
10. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



Kufiri i Zonës për Rishikim: Njësia Strukturore DJ_B_B_4




Figura 2. Pozicioni i investimeve sipas vendimeve të KIS; Nënnyësia Strukturore DJ_B_B_4

	Përshkrim	Njësi me karakter bujqësor.
1	Kodi i njësisë	DJ_B_B_4
2	Sipërfaqe	399 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullore	-
5	Sistemi	Bujqësor - B
6	Kategori përdorimi toke	Tokë Bujqësore - B
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	Infrastrukturë Bujqësore - IB Infrastrukturë Transporti - INT
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	Kultura të përhershme - B1 Kultura të përkohshme - B2 Të lejuara: Infrastrukturë vaditje dhe kullimi - IB3 Infrastrukturë rrugore - INT1
12	Intensiteti i ndërimit (I)	-
13	KSHT	-
14	KSHR	0.5%
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	-
17	Lartësia (metra)	-
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	-
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.

Figura 3. Pasaporta e Nënnyësisë Strukturore DJ_B_B_4

